



Pranuar / Dorezuar Prilježen / Predato Received / Delivery	29.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	8601/2022		1/5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1016/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1016/2022 të datës 16.11.2022, të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike "*shkelje e të drejtës në pagë*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 28.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1016/2022 e datës 16.11.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Gjakovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunës civil nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja është e punësuar në Komunën e Gjakovës, sipas Akt Emërimit AE.Nr.01-112/01-37780 të datës 16.12.2021 në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizmit", në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Me datën 10.11.2022 fillimisht ka



parashtruar kërkesë tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjakovës lidhur me harmonizimin e koeficientit nga shtatë pikë pesë (7.5) në tetë pikë pesë (8.5).

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, me datën 11.11.2022 ka kthyer përgjigjen me numër 01-120/01-25628, sipas së cilës e ka njoftuar se e kanë të pamundur të aprovojme kërkesën tuaj lidhur me harmonizimin e koeficientit nga 7.5 në 8.5. Ndërsa me datë 14.11.2022 përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është protokolluar me datë 16.11.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 25.11.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoli 7437/2022 tek Komuna e Gjakovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 14.12.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Gjakovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me nr.protokoli 7171/2022 të datës 16.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigje në kërkesë nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës i datës 11.11.2022; Kërkesë për harmonizim të koeficientit me numër protokoli 01-120/01-25628 i datës 10.11.2022; Akt Emërim i E.B. i datës 16.12.2021; Akt Emërim i E.B. i datës 27.03.2012; Akt Emërim i D.Rr. i datës 15.07.2021; Akt Emërim i F.G. i datës 13.12.2021; Akt Emërim i T.V. i datës 13.12.2021; Akt Emërim i G.Q.N. i datës 16.08.2021; Akt Emërim i B.Q. i datës 14.12.2021; Vendim me Nr.01-112/02-35987 i datës 30.11.2021; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokoli 6127/2022 i datës 12.10.2022; Pliko me numër R2452378 i datës 14.11.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.11.2022; Përgjigje në ankesë e datës 14.12.2022; Përgjigje në ankesë e datës 13.12.2022; Përshkrimi i detyrave të punës; Lista e pagave prej datës 01.10.2022 deri 31.10.2022; Lista e pagave prej datës 01.11.2022 deri 30.11.2022; Shkresa e Ministrisë së Administratës Publike e datës 20.11.2014;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës përkatësisht sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.01-112/01-37780 të datës 16.12.2021, Kolegji ka gjetur së ankuesja është emëruar në pozitën "Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizimit", në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjakovës me koeficient 7.5 të pagës. E njëjta me datë 10.11.2022, parashtron kërkesë me numër 01-120/01-25628 drejtuar Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunë të Gjakovës, për harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë ( 7.5 ) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5), ndërsa me datë 11.11.2022 Menaxheri i Burimeve Njerëzorë në Komunën e Gjakovës përmes përgjigjes me numër reference: 01-120/01-25628 njofton ankuesin se shumica e udhëheqëseve të sektorëve marrin pagë sipas koeficientit 7.5. dhe për shkak të buxhetit të vitit 2022 e kemi të pamundur të aprovojme kërkesën e juaj.





Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Komuna duhet të bëjë harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5) pasi që për punën e njëjtë duhet vleve paga e njëjtë sipas parimeve të përgjithshme të legjislacionit për pagat e nëpunësve civil.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses Kolegji i Këshillit i'u referua nenit 33 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin është përcaktuar se: "Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë", ndërlidhur me këtë, neni 12 i Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil e ka përcaktuar se: "Drejtues i Ulët kategorizohet Udhëheqës i Divizionit në një Agjenci Ekzekutive; 2. Udhëheqës i Sektorit në një Komunë", andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rrjedhë së pozita "Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizmit", hyn në kategorinë drejtues i ulët 2.

Po ashtu lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë...., dhe rrjedhimisht konstatohet se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Andaj, në vështrim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së organi i punësimit respektivisht Komuna e Gjakovës ka aplikuar koeficient të ndryshëm lidhur me pozitat e udhëheqëseve të sektorëve brenda Komunës si pozita të kategorisë së njëjtë të punës, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale ka konstatuar se sipas Akt Emërimit të datës 15.12.2021 Udhëheqësi i Sektorit për Transport dhe Trafik e ka koeficient 8 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit për Shërbime Profesionale sipas Akt Emërimit të datës 15.07.2021 ka koeficient 8.5 të pagës, Udhëheqësja e Sektorit për Gjendje Civile sipas Akt emërimit të datës 13.12.2021 e ka koeficient 8.5 të pagës, Udhëheqësi i Prokurimit sipas Akt Emërimit të datës 13.12.2021 ka koeficient 8.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Buxhetit sipas Akt Emërimit të datës 16.08.2021 ka koeficient 8.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit për Mirëqene Sociale sipas Akt Emërimit të datës 14.12.2021 ka koeficient 8.5 të pagës, Zv. Udhëheqësi e Sektorit për Raportim, sipas Vendimit të datës 30.11.2021 e ka koeficient 8.5 të pagës, ndërsa udhëheqësit e sektorëve të tjerë duke përfshirë edhe ankuesen si ,, "Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizmit" kanë koeficient 7.5 të pagës. Kështu që bazuar në këto fakte dhe konstatime, Kolegji vlerëson së aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: "Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji", dhe se trajtimi jo i barabartë i të punësuarve të së njëjtës kategori brenda të



njëtit institucioni është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Në kuptim të parimit *pagë e njëjtë për punë të njëjtë* i përcaktuar me nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, Këshilli më datë 19.09.2022 dhe 03.10.2022 i është drejtuar me shkresë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, si organ përgjegjës për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për pagat e zyrtarëve publikë dhe funksionarëve publikë, duke kërkuar informacione në lidhje me koeficientin e pagës për titullin e punës *Udhëheqës të Sektorit*, ndërsa kjo e fundit duke u përgjigjur në kërkesë, më datë 04.10.2022 ka njoftuar se në bazë të Shtojcës Nr.1/7 të Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, kjo pozitë sipas katalogut të vendeve të punës është përcaktuar pozite e nivelit Drejtues i Ulët 2 me koeficienti të pagës tetë pikë pesë (8.5).

Kolegji i Këshillit, po ashtu, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar edhe provat tjera materiale të lëndës, respektivisht shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 10.11.2014 të lëshuar nga Drejtori i Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil/MAP, për Sekretarët e Përgjithshëm, për Drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe Menaxherët e Personelit të institucioneve publike përmes të cilës shkresë janë vendosur koeficientet e pozitave përkatëse rrjedhimisht për pozitën Udhëheqës i sektorit është vendosur koeficient tetë pikë pesë (8.5).

Andaj, nisur nga konstatimi se ankuesja mban pozitën e punës "Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizmit", e për të cilat pozita organi përgjegjës për administrimin e Shërbimit Civil (DASHC) kishte vendosur koeficientin e pagës tetë pikë pesë (8.5), dhe në kuptim të dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, Kolegji i Këshillit konstaton se në këtë çështje administrative janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e ankesës së ankueses duke i dhënë të drejtë ankueses për rregullimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5), në tetë pikë pesë (8.5), për pozitën e punës "Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizmit" në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjakovës

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1016/2022.

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.